



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 303 Prot.

Tiranë, më datë 12.07.2019

VENDIM

Nr.252, datë 12.07.2019

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 12.07.2019, pas shqyrtimit më parë edhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e preventivit të rishikuar të projektit “Ringritja e murit lindor dhe restaurimi i murit ndarës midis oborrit të parë e të dytë në anën lindore të Kalasë së Shkodrës”, hartuar nga specialistët e DRKK Shkodër, miratuar me Vendim KKR Nr.130, datë.07.05.2019.
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1;
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elva MARGARITI

SEKRETAR I KKR

Arta Dollani

